



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

RAPORT

DEKLARIMI I DHURATAVE TË PRANUARA NGA INSTITUCIONET GJATË VITIT 2015

PRISHTINË, QERSHOR 2016

1/2

Katalogu i dhuratave

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 si dhe Ligjin Nr. 04/L-228, Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrin të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në AKK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

Dorëzimi i katalogut të dhuratave

Agjencia kundër Korrupsionit, gjatë muajit mars të vitit 2016 ka pranuar njoftimin nga njëmbëdhjete (12) institucione të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa tredhjet e gjashtë (36) institucione tjera kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit paraprak.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak janë: Presidenca 30 dhurata; Kuvendi i Kosovës 25 dhurata; Zyra e Kryeministrit 14 dhurata; Ministria e Integritetit Evropian 16 dhuratë; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 3 dhurata; Këshilli Kombëtar për Trashëgimi Kulturor 3 dhurata; Policia e Kosovës 2 dhurata; Gjykata Kushtetuese 4 dhurata; Prokuroria e Shtetit 10 dhurata; Zyra e Prokurorit Disiplinor 5 dhurata; dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm 14 dhurata.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Institucioni	Protokollare	Rastit	Numri i përgjithshëm
Presidenca	26	4	30
Kuvendi	25	0	25
Zyra e Kryeministrit	9	5	14
Ministria e Integritetit Evropian	4	12	16
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	3	0	3
Këshilli Kombëtar për Trashëgimi Kulturor	3	0	3
Policia e Kosovës	2	0	2
Gjykata Kushtetuese	4	0	4
Prokuroria e Shtetit	10	0	10
Zyra e Prokurorit Disiplinor	5	0	5
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	0	14	14
Totali	91	35	126